



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

P R O J E K T L I G J

Nr._____/2019

PËR

DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.43/2015,
“PËR SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

Në ligjin nr.43/2015, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Fjalja e dytë, e pikës 4, të nenit 17, shfuqizohet.

Neni 2

Fjalja e parë dhe e dytë e pikës 5 si dhe pika 7, e nenit 28, shfuqizohen.

Neni 3

Pika 1, e nenit 31, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Linjat e reja të interkoneksionit, që ndërtohen nga investitorët privatë, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë.”.

Neni 4

Në pikën 2, të nenit 49, pas shkronjës “h” shtohet shkronja “i”, me këtë përmbajtje:

“i) zhvillimin e procesit konkurrues për miratimin e ndërtimit të kapaciteteve prodhuese të energjisë nga hidrocentralet.”.

Neni 5

Pika 8, e nenit 60, shfuqizohet.

Neni 6

Shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 3, të nenit 72, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“a) Të ketë të drejta të plota vendimmarrëse, të pavarura nga shoqëria e integruar e energjisë elektrike, lidhur me asetet e nevojshme për funksionimin, mirëmbajtjen ose zhvillimin e rrjetit të shpërndarjes.

Për të përmbushur këto detyra, operatori i sistemit të shpërndarjes duhet të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, përfshirë burimet njerëzore, teknike, fizike dhe financiare.

Shoqëria mëmë (kontrolluese) ka të drejtën e mbikëqyrjes ekonomike dhe menaxheriale, në lidhje me kthimin e aktiveve, miratimin e planit ekonomik financiar ose çdo instrument tjetër të barasvlershëm të operatorit të sistemit të shpërndarjes dhe të vendosë kufijtë e përgjithshëm në nivelet e borxhit të shoqërisë bijë (të kontrolluar).

Shoqëria mëmë (kontrolluese) nuk mund të japë udhëzime për veprimtarinë e përditshme operacionale të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë dhe nuk ka të drejtë të marrë vendime lidhur me ndërtimin apo rikonstruksionin e linjave të shpërndarjes, vlera e investimit e të cilave nuk tejkalon nivelet e planeve financiare të miratuara apo vlerat e përcaktuara në statutin e shoqërisë apo legjislacionin në fuqi;

b) Të hartojë një program pajtueshmërie që përcakton masat që do të merren për të siguruar ndalimin e veprimeve diskriminuese, si dhe të sigurojë që respektimi i programit të monitorohet në mënyrën e duhur. Programi i pajtueshmërisë përcakton detyrimet specifike të punonjësve për përmbushjen e këtij objekti.

Personi ose organi përgjegjës për monitorimin e programit të pajtueshmërisë (zyrtari i pajtueshmërisë së operatorit të sistemit të shpërndarjes) paraqet çdo vit në ERE një raport vjetor, i cili përcakton masat e marra në kuadër të programit të pajtueshmërisë. Ky raport publikohet në faqen zyrtare të ERE-s.

Zyrtari i pajtueshmërisë së operatorit të sistemit të shpërndarjes është plotësisht i pavarur dhe ka akses në të gjitha informacionet e nevojshme të operatorit të sistemit të shpërndarjes dhe çdo shoqërie të lidhur, për të përmbushur detyrën e tij.”.

Neni 7

Dispozitë kalimtare

Parashikimi i nenit 4, të këtij ligji, nuk zbatohet për subjektet që janë pajisur me “Miratim paraprak”, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E T A R I

GRAMOZ RUÇI